# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



2013

6-mujorin e I-rë -2013

# BULETINI

2

Tiranë, 2013

Adresa:
KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.3,
Tiranë

Tel: ++355 (04) 251267
Fax: ++355 (04) 232491
E-mail: klsh@klsh.org.al
WWW.klsh.org.al

# MBI REALIZIMIN E TREGUESVE KRYESORË TË VEPRIMTARISË AUDITUESE TE KLSH, PËR 6-MUJORIN E PARË TË VITIT 2013

Për 6-mujorin e I-rë të vitit 2013, Kontrolli i Lartë i Shtetit, kishte planifikuar te ushtronte ***83 auditime, në fakt ka ushtruar dhe ka vijuar me përgatitjen e materialeve për 121 auditime***, nga të cilat:

- **71** janë të përfunduar e të evaduar, ku:
  - *53 përputhshmërie (ligjshmëri dhe rregullshmëri financiare)*
  - *11 auditime financiare*
  - *5 tematikë*
  - *2 performance* (Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave SHA Durrës "Shërbimi Hekurudhor, nevoja për ndryshim" dhe Ujësjellës Kanalizime sh.a. Pogradec "Vlerësimi i performancës në furnizimin me ujë të pijshëm të konsumatorëve dhe largimin e ujrave të përdorura").
- **20** janë të përfunduar si proces auditimi në subjekt, por të paevaduar;
- **30** janë në proces auditimi.

Struktura e subjekteve të audituar e të evaduar, gjatë kësaj periudhe 6-mujore, jepet më analitikisht në formularin nr. 1, bashkëlidhur.

**Auditimet e përfunduar janë ushtruar në:**

- Ministritë dhe institucionet qendrore........................................................ 17
- Institucionet e administratës së qeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor 28
- Drejtoritë dhe degët e tatimtaksave e të doganave........................................ 9
- Institucionet financiare dhe shoqëritë me kapital të përbashkët shtetëror................. 6
- Njësitë dhe projektet me financime të huaja................................................. 8
- Subjekte të mbrojtjes së mjedisit............................................................... 3

Përveç auditimeve të mësipërme, gjatë kësaj periudhe 6-mujore, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka trajtuar edhe 231 *letra dhe ankesa,* për probleme të ndryshme, nga të cilat 108 ***rezultuan jashtë kompetencave dhe juridiksionit të institucionit.***

Nga **123** kërkesa dhe ankesa në kompetencë të KLSH, 70 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigja përkatëse, ndërsa 53 janë në procesin e verifikimit.

*Nga auditimet e ushtruara gjatë kësaj periudhe janë zbuluar p**arregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm efektiv dhe me ndikim negativ në perfomancën e subjekteve të audituara, në shumën e përgjithshme 934 419 000 lekë.***

Këto shkelje financiare me dëm efektiv dhe ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituar i përkasin veprimtarisë ekonomiko-financiare për periudhën kohore 2007-2012 dhe tremujorit të I-rë të vitit 2013, përcaktuar për çdo subjekt të audituar në programet e auditimit.

## I. SHKELJET ME DËM EKONOMIK JANË KONSTATUAR SI MË POSHTË:

### 1. Në sektorin e doganave, në vlerën e përgjithshme prej 182 346 000 lekë, e konstatuar në:

- Degën e Doganës, Durrës, në vlerën totale prej 55 810 000 lekë, ***si detyrime doganore të papaguara në zhdoganimet e bëra në vlerën prej 1 114 000 lekë; të ardhura të munguara nga klasifikimi i gabuar i kodit tarifor në vlerën prej 36 372 000 lekë; kundravajtje administrative në vlerën 399 000 lekë dhe rivlerësim bazuar në çmimet reference në vlerën 17 925 000 lekë.***
- Degën e Doganës, Kapshticë, në vlerën totale prej 32 684 000 lekë, ***të ardhura doganore të munguara nga diferenca në peshën e mallrave në vlerën prej 29 328 000 lekë; detyrime doganore për shkelje të konstatuar lidhur me RPA dhe RLP në vlerën prej 2 167 000 lekë; vendimmarje administrative të pabazuara në kërkesat e ligjit me dëm financiar në vlerën prej 1 189 000 lekë.***

- Degën e Doganës, Berat, në vlerën totale prej 17 334 000 lekë, *vendimmarrje të gabuara nga autoriteti doganor i saj me efekt financiar në vlerën prej 12 163 000 lekë; detyrime të palikuiduara për rentën minerare në shumën 1 791 000 lekë; detyrime për të cilat nuk janë nxjerrë vendime administrative në shumën 2 560 000 lekë; penalitete të pa vendosura ndaj subjekteve në vlerën prej 750 000 lekë dhe të ardhura të munguara nga klasifikimi i gabuar i kodit tarifor në vlerën prej 70 000 lekë.*

- Degën e Doganës, Lezhë, në vlerën totale totale 12 168 000 lekë, *si detyrime të pakontabilizuara në shumën 1 332 000 lekë; të ardhura doganore të munguara nga diferenca në peshën e mallrave në shumën 7 946 000 lekë dhe detyrime doganore për shkelje të konstatuara në regjimin e përpunimit aktiv dhe regjimin e lejimit të përkohshëm në shumën 2 890 000 lekë.*

- Degën e Doganës, Elbasan, në vlerën totale prej 1 474 000 lekë, *si penalitete të pa vendosura per kundravajtje administrative ndaj subjekteve importues dhe eksportues.*

- Degët e Doganave: Kakavijë dhe 3-Urat, Përmet, në vlerat repektive prej 53 148 000 lekë dhe 9 728 000 lekë, *si detyrime doganore të papaguara*, *shkelje të konstatuara në regjimin e përpunimit aktiv dhe regjimin e lejimit të përkohshëm etj.*

2. Në fushën e prokurimeve, në vlerën e përgjithshme prej 167 781 000 lekë, e konstatuar në:

- Bashkinë Durrës………………………………………………………. 57 275 000 lekë
- Autoritetin Rrugor Shqiptar…………………………………………. 38 039 000 lekë
- Bashkinë Kavajë………………………………………………………. 20 925 000 lekë
- MPÇS dhe SHB, Tiranë………………………………………………. 13 795 000 lekë
- Komunën Gjinar, Elbasan……………………………………………. 11 840 000 lekë
- Bashkinë Belsh……………………………………………………….. 7 657 000 lekë
- Bashkinë Vau-Dejës………………………………………………….. 4 201 000 lekë
- Bashkinë Kuçovë……………………………………………………... 2 996 000 lekë
- Bashkinë Koplik………………………………………………………. 2 035 000 lekë
- Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë……………. 1 790 000 lekë

- Ndërmarjen nr. 1, Bashkia Tiranë…………………………………… 1 785 000 lekë
- Bashkinë Roskovec………………………………………………… 1 360 000 lekë
- Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Tiranë……………………... 952 000 lekë
- Bashkinë Fushë-Krujë……………………………………………... 888 000 lekë
- Komunën Levan, Fier……………………………………………... 848 000 lekë
- Bashkinë Libohovë………………………………………………… 650 000 lekë
- Bashkinë Çorovodë………………………………………………... 278 000 lekë
- Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë….. 254 000 lekë
- Bashkinë Fushë-Arëz……………………………………………… 170 000 lekë
- Degën e Doganës, 3-Urat, Përmet…………………………………… 43 000 lekë

3. Ne sektorin e tatimtaksave, në vlerën e përgjithshme prej 59 340 000 lekë, e konstatuar në:

- Projektin "Rehabilitimi i hidrocentralit Bistrica 1 e 2", KESH Sh.a. në vlerën 44 933 000 lekë, *si pasojë e mosmbajtjes dhe mosderdhjes së tatimit në burim në masën 10%, për të ardhurat e përfituara.*
- Bashkinë Sukth në vlerën 4 006 000 lekë, *për mosarkëtim të taksës bujqësore dhe mosvjelje detyrimesh për sezonin turistik.*
- Bashkitë: Fushë-Krujë, Libohovë, Belsh, Vau-Dejës, Manëz e Roskovec në vlerat respektive 3 595 000 lekë, 1 055 000 lekë, 986 000 lekë, 321 000 lekë, 208 000 lekë e 19 000 lekë, *për mosvjelje të detyrimeve tatimore nga subjektet.*
- Bashkinë Kavajë në vlerën 3 260 000 lekë, *për mosmbajtje të tatimit në burim dhe përfitim i padrejtë i t.v.sh.*
- Agjencinë e Kërkimit Teknik dhe Inovacionit, Tiranë në vlerën 311 000 lekë, *e përfituar padrejtësisht nga Shoqeria private "Studio D, Tirana" si pasojë e llogaritjes të vlerës së tatimit në burim në kundërshtim me vendimin e Bordit Drejtues gjatë zbatimit të projektit "Studimi Kombëtar mbi Delikuenca" të financuar nga AKTI në kuadër të PKKZH.*
- Komunë Levan, Fier në vlerën 265 000 lekë, *për mosllogaritje dhe mosarkëtim të taksës së investimit nga operatorët privat.*

- Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Tiranë, Ministrinë e Integrimit, Tiranë dhe Avokatin e Prokurimeve, Tiranë në vlerat respektive 226 000 lekë, 131 000 lekë dhe 6 000 lekë *si përfitime të padrejta nga punonjës të tyre nga mos llogaritja dhe mos ndalja e tatimit mbi të ardhurat personale.*
- Bashkinë Kuçovë në vlerën 8 000 lekë, *për mosmbajtje të tatimit në burim.*
- Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Tiranë, në vlerën 7 000 lekë, *e përfituar padrejtësisht nga një përkthyes nga mos llogaritja dhe mos ndalja e tatimit mbi të ardhurat e përfituar për përkthimet e bëra.*

4. Në fushën e sistemit të pagave, në shumën e përgjithshme prej 45 299 000 lekë, e konstatuar në:

- Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Tiranë, në vlerën totale prej 4 282 000 lekë*, si përfitime pagesash të padrejta nga 33 punonjës në shumën 1,783 mijë lekë për pushimet vjetore të pakryera në vitin 2010, në kundërshtim me VKM nr. 472, datë 2.7.2011 "Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore" dhe UMF nr 16, datë 20.7.2011; si përfitime të padrejta nga 16 punonjës në shumën 1,918 mijë lekë për pagesat e kryera për orë pune jashtë kohës normale të punës, në kundërshtim me VKM nr. 472, datë 2.7.2011 "Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore"dhe UMF nr 19, datë 10.7.2008 si edhe si përfitim i padrejtë i pagës së një Këshilltari të Ministrit në shumën 581 mijë lekë për kohën që nuk ishte prezent në Shqipëri (prej 7.3 muaj, në periudhën nga data 30.10.2011 deri më 22.12.2012).*
- Institutin e Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë, në vlerën 1 080 000 lekë, *si përfitim i padrejtë i shtesës mbi pagë për kualifikimet postmaster për 9 punonjës për vitin 2012, në kundërshtim me rubrikën nr. 2, të lidhjes nr.2/1, të VKM nr. 449, datë 11.07.2012 "Për një ndryshim në VKM nr. 545, datë 11.08.2011, "Për miratimin e strukturësdhe të niveleve të pagave të nëpunësve civil/ nëpunësve ........" dhe me pikën 12 të Udhëzimit të përbashkët nr. 1, datë 16.03.2012 të MF, MASH dhe Departamentit të Administratës Publike.*

- Ndërmarjen nr. 1, Bashkia Tiranë, Ndërmarjen nr. 2, Bashkia Tiranë, Ndërmarjen nr. 3, Bashkia Tiranë dhe Avokatin e Prokurimeve, Tiranë në vlerat respektive 17 679 000 lekë, 16 607 000 lekë, 1 169 000 lekë dhe 43 000 lekë, *si pagesa të dhëna jashtë kohës normale të punës, të pajustifikuara ligjërisht.*

- Institutin e Statistikës, Tiranë, në vlerën 325 000 lekë, *si përfitim i padrejtë për orë pune mbi kohën normale të punës të titullarit të institucionit, pasi në kundërstim me kërkesat e dispozitave ligjore, nuk ka marrë paraprakisht urdhër me shkrim nga Kryeministri, si eprori direkt,*

- Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë, në vlerën 27 000 lekë, *si pagesë e përfituar padrejtësisht nga 1 person*, *në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.*

- Degët e Doganave: 3-urat Përmet, Kakavijë dhe Durrës në vlerat respektive 465 000 lekë, 158 000 lekë dhe 48 000 lekë, *si përfitime pagesash të tepërta në kundërshtim me dispozitat ligjore.*

- Bashkitë: Koplik, Krumë, Vau-Dejës e Manëz, në vlerat respektive 1 218 000 lekë, 353 000 lekë, 262 000 lekë e 57 000 lekë, *si shtesë e padrejtë page për pozicion dhe shtesë mbi organik.*

- Bashkinë Kuçovë në vlerën 535 000 lekë, *si shtesë e padrejtë page për pozicion dhe shtesë page për diplomë të shkolles së lartë*

- Bashkinë Belsh në vlerën 322 000 lekë, *si perfitim page të padrejtë nga sekretarja e Kryetarit.*

- Komuna Levan, Fier në vlerën 383 000 lekë, *përfituar pagë më tepër nga përcaktimet ligjore.*

- Bashkinë Fushë-Arëz, në vlerën 286 000 lekë, *si përfitim page të padrejtë për lejen e zakonshme të pabërë.*

5. Në fushën e shitjes dhe dhënies me qira të pasurisë shtetërore, në shumën e përgjithshme prej 17 449 000 lekë, konstatuar në:

- Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë dhe Sh.a. "Trajtimi i Studentëve nr. 2", Tiranë në vlerat respektive 7 437 000 lekë dhe 84 000 lekë *për mosarkëtim të qirave për ambientet e dhëna me qira të tretëve.*
- Ndërmarjen nr. 1, Bashkia Tiranë, në vlerën 5 142 000 lekë, *për moslikuidim të qirasë për truallin e marrë me qira.*
- Bashkitë: Kavajë, Kuçovë, Vau-Dejës, Bilisht dhe Komunën Kolsh, Kukës në vlerat respektive 202 000 lekë, 29 000 lekë, 23 000 lekë, 287 000 leke dhe 1 820 000 lekë, *për mosshlyerje të detyrimeve sipas kontratës së qirasë për objekte të marra me qira.*
- Ministrinë e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës, Tiranë, në vlerën 2 236 000 lekë, *si diferencë qireja e pa paguar nga Shoqëria "Iliad 1" shpk për objektin "Parku i Lojrave, Qyteti Vlorë nga data 04.06.2012 e në vazhdim.*
- Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Tiranë, në vlerën 139 000 lekë, *nga mosarkëtimi i qirasë nga një person fizik për objektin "Ushqim social dhe bufe" me sipërfaqe 65,5 m$^2$.*
- Bashkinë Belsh në vlerën 23 000 lekë, *për mosaplikim të çmimit të qirasë.*
- Komunën Levan, Fier në vlerën 27 000 lekë, *për mosaplikim të qirasë për tokë bujqësore.*

6. Në fushën e urbanistikës, në shumën e përgjithshme prej 12 822 000 lekë, e konstatuar në:

- Bashkitë: Vau-Dejës; Krumë; Kuçovë; Durrës; Kavajë; Fushë-Krujë; Roskovec; Libohovë dhe Komuna Dishnicë, Përmet, në vlerat respektive, 4 736 000 lekë, 4 475 000 lekë, 1 482 000 lekë, 1 344 000 lekë, 249 000 lekë, 49 000 lekë, 163 000 lekë, 55 000 lekë dhe 208 000 lekë, *për mosarkëtim të detyrimeve për leje ndërtimi.*
- Bashkinë Manëz, në vlerën 61 000 lekë, *si diferencë e papaguar në llogaritjen e taksës së lejes së ndërtimit.*

7. Në fushën e shpenzimeve operative, në shumën e përgjithshme prej 15 819 000 lekë, e konstatuar në:

- MPÇS & SHB, Tiranë………………………………………………… 6 262 000 lekë
- Bashkinë Koplik…………………………………………………… 1 393 000 lekë
- Institutin e Statistikës, Tiranë……………………………………….. 1 203 000 lekë
- Bashkinë Sukth…………………………………………………… 867 000 lekë
- Qendrën e Trajtimi të Studentëve, Sh.a., Shkodër………………….. 823 000 lekë
- Degën e Doganës, 3-Urat Përmet……………………………………. 777 000 lekë
- Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Tiranë……………………... 641 000 lekë
- Prefekturën Korçë…………………………………………………. 463 000 lekë
- Bashkinë Kuçovë…………………………………………………... 442 000 lekë
- Bashkinë Belsh…………………………………………………….. 428 000 lekë
- Bashkinë Divjakë…………………………………………………... 425 000 lekë
- Bashkinë Manëz…………………………………………………… 357 000 lekë
- Bashkinë Roskovec………………………………………………… 280 000 lekë
- Bashkinë Çorovodë………………………………………………… 223 000 lekë
- Bashkinë Vau-Dejës……………………………………………….. 216 000 lekë
- Komuna Kolsh, Kukës…………………………………………….. 210 000 lekë
- Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë….. 198 000 lekë
- Institutin e Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë……………... 154 000 lekë
- Bashkinë Kavajë…………………………………………………… 120 000 lekë
- Komuna Dishnicë, Përmet…………………………………………. 114 000 lekë
- Degën e Doganës, Durrës………………………………………….. 101 000 lekë
- Bashkinë Krumë…………………………………………………… 50 000 lekë
- Bashkinë Libohovë………………………………………………… 40 000 lekë
- Ndërmarja nr. 2, Bashkia Tiranë………………………………….. 32 000 lekë

8. Në fushën e shpërblimeve, në shumën e përgjithshme prej 729 000 lekë, e konstatuar në:

- Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Tiranë, në vlerën 451 000 lekë, *si dëme ekonomike nga pagesat e kryera pa dokumenta justifikues dhe në kundërshtim me dispozitat*

*ligjore për organizimin e festës së 8 marsit 2010 në shumën 153 000 lekë dhe të një vitit të ri 2010 në shumën 298 000 lekë, që nuk janë evidentuar nga auditimi i kryer nga SAB (sektori i auditimit të brëndshëm) në IEVP Lezhë.*

- Avokatin e Prokurimeve, Tiranë, në vlerën 213 000 lekë, *si përfitim shpërblimi të padrejtë për 12 punonjës të institucionit në vitin 2007, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në VKM Nr. 369, dt. 13.06.2007 "Për fondin e veçantë në institucionet buxhetore", pika 2, pa caktuar dhe evidentuar punën e mirë të kryer prej tyre, ndërkohë që koha e tyre e punës në institucion ishte afërsisht 2 muaj.*
- Bashkinë Krumë në vlerën 55 000 lekë, *si shpërblim i padrejtë nga fondi rezervë për anëtarët e Këshillit Bashkiak.*
- Degët e Doganave: Durrës e Lezhë, në vlerat respektive 6 000 lekë e 4 000 lekë, *si shpërblime të përfituar padrejtësisht nga punonjësit.*

9. Në mungesë materiale në shumën e përgjithshme prej 9 489 000 lekë, e konstatuar në:

- Komunën Levan, Fier, në vlerën 7 346 000 lekë, *mungesë materiali, mjet "Skrep"*
- Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Tiranë, në vlerën 1 081 000 lekë, *si dëm ekonomik nga dëmtimi i një trasfomatori në shumën 470 000 lekë dhe pagesë e padrejtë në favor të Komisariatit të Policisë Nr. 1, Tiranë dhe të punonjësve të Burgut 313 Tiranë të shumës 611 000 lekë në kundërshtim me vendimet e Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 5263, datë 04.11.2004.*
- Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Tiranë, në vlerën 730 000 lekë, *vlera e materialeve që mungojnë në inventarin e sallës së mbledhjeve të MPÇSSHB në ngarkim të një punonjësi përgjegjës.*
- Bashkinë Kuçovë, në vlerën 332 000 lekë, *si mungesë materiali asfaltobeton, gjendje kontabile në magazinë.*

10. Në zërin "të tjera", shkelje të disiplinës financiare në shumën e përgjithshme prej

29 487 000 lekë, që i përkasin:

- Agjencisë se Kërkimit Teknik dhe Inovacionit, Tiranë, në vlerën totale prej 10 352 000 lekë, *si përfitim i padrejtë, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në kuadrin ligjor përkatës, në shumën 8 015 000 lekë nga një shoqëri private gjatë zbatimit të projektit "Model Kodi i Prodhuesve të Ujit" financuar nga AKTI në kuadër të Programit Kombëtar për Kërkim Zhvillim (PKKZH); si përfitime honorare të padrejta, në kundërshtim me vendimin e Bordit Drejtues, në shumën 1 300 000 lekë nga një shoqëri private gjatë zbatimit të projektit "Studimi Kombëtar mbi Delinkuencën" financuar nga AKTI në kuadër të PKKZH; si përfitim i padrejtë në shumën 883 000 lekë të drejtuesit dhe personelit të subjektit jo publik gjatë zbatimit të projektit "Modele parashikues për sezonin Polenik të disa Bimëve Alergjizuese" financuar nga AKTI në kuadër të PKKZH; si edhe nga mosllogaritja e mosmbajtja në favor të ISSH të kontributit suplementar të sigurimeve shoqërore në shumën 154 000 lekë, për shumat e përfituara nga titullari i institucionit për titullin profesor.*
- Projektit "Cilësi dhe barazi në arsim"; Projektit "Ndërtimi i terminalit të trageteve"; Projektit "Furnizimi me ujë në qytetet Berat e Kuçovë" dhe Sh.a. "Trajtimi i Studentëve nr. 2", Tiranë, në vlerat respective, 6 964 000 lekë, 6 509 000 lekë, 4 215 000 lekë dhe 1 122 000 lekë, *si përfitime të padrejta për punime të pakryera, ku janë raportuar volume më të mëdha se ato të kryera në fakt.*
- Ministrisë së Integrimit, Tiranë, në vlerën 156 000 lekë, *nga mos llogaritja e saktë dhe mos ndalesa e detyrimve për kontributet e sigurimeve shëndetësore për 36 punonjës.*
- Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Tiranë, në vlerën 57 000 lekë, *nga mos llogaritja dhe mos ndalesa e sigurimeve shëndetësore për lejet e zakonshme për 9 punonjës.*
- Bashkinë Belsh, në vlerën 112 000 lekë, *si gjoba të policisë të pa vjela.*

## II. *SHKELJE TË DISIPLINËS FINANCIARE ME NDIKIM NEGATIV NË PERFOMANCËN E SUBJEKTEVE TË AUDITUARA, JANE KONSTATUAR NË:*

- Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, *në vlerën totale prej 329 579 000 lekë, nga tejkalimi i fondit të pagave me vlerën 258 000 000 lekë, si pasojë e*

*emërimeve mbi dhe jashtë strukturave të miratuara, emërimeve me kontratë të përkohëshme të pa miratuar me VKM dhe emërime e levizje punonjësish me destinacione të tjera të pamiratuara, në kundërshtim me dispozitat ligjore për marrjen në punë të punonjësve; nga pagesa të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për largim të padrejtë nga puna (10 raste në vitin 2011 dhe 4 raste në vitin 2012) në shumën prej 6 303 000 lekë; nga skadenca e medikamenteve në vlerën 65 276 000 lekë për shkaqe objektive si edhe të programimeve të gabuara e nga mospërcaktimi në kontratë i masave për rifreskimin e medikamenteve që afron data e skadencës;*

- Drejtorinë e Përgjithshme e Burgjeve, Tiranë, në vlerën totale 24 149 000 leke, *si pasojë e pagesave të kamat vonesave dhe të fitimit të munguar për një subjekt për mos likuidim në afat të detyrimeve kontraktore në vlerën 2 700 000 lekë; humbjes financiare prej 3 893 000 leke nga skadenca e 39 artikujve (medikamente); humbjes financiare prej 2 500 000 lekë nga mosshfrytëzimi i një pusi uji të vet që do të zvogëlonte 50% të nevojave për ujë të furnizuar nga Ujësjellësi Peqin; pagesa të vendimeve gjyqësore për moslikuidim në afat të faturave të furnizimit me mallra prej 7 466 000 lekë* (nga detyrimi total prej 17 842 000 lekë) *dhe pagesa të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për largim të padrejtë nga puna prej 7 591 000 leke* (ndërkohë që detyrimi total është 39 246 000 lekë).

- Avokatin e Prokurimeve, Tiranë, *si pagesë më tepër prej 1 000 000 lekë nga vlera e prokurimit të shërbimit të pastrimit të zyrave.*

- Ministrinë e Integrimit, Tiranë, *si pagesa të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për largim të padrejtë nga puna në dy raste në vlerën 7 889 000 lekë*

- Institutin e Statistikës, Tiranë, në vlerën totale prej 6 648 000 leke, *si pagesa të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për largim të padrejtë nga puna në dy raste në vlerën 992 000 lekë; penalitete prej 2 252 000 lekë për moslikuidim kontrate shoqëruar me taksa përmbarimore në vlerën 516 000 lekë si edhe pagesa për orë pune jashtë kohës normale të punës të paargumentura dhe jo efektive prej 2 888 000 lekë.*

- Agjencinë e Prokurimit Publik, Tiranë, *si pagesa të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për largim të padrejtë nga puna në dy raste në vlerën 766 000 lekë.*

- Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Tiranë, *si pagesa të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për largim të padrejtë nga puna për 51 raste në vlerën 26 621 000 lekë (nga të cilët vetëm për vitin 2012 janë paguar 27 raste në shumën 10 150 000 lekë).*

*

* *

Për parregullsitë dhe shkeljet financiare në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik dhe me ndikim negativ në perfomancën e subjekteve, që jane pasqyruar në raportet e auditimit të evaduar gjatë kësaj periudhe 6-mujore, *KLSH-ja ka rekomanduar zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar në masën 100% të tij.*

Për të metat dhe shkeljet e konstatuara për çdo subjekt të kontrolluar, në bazë të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, KLSH-ja ka lënë detyra për zbatim, duke njoftuar edhe institucionet apo nomenklaturat përkatëse, si dhe ka bërë publike rezultatet e auditimeve në median e shkruar dhe atë elektronike.

Gjithashtu, për shkeljet e konstatuara në bazë të ligjit të mësipërm, ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe disa ligjeve të tjera në fuqi, KLSH-ja u ka kërkuar organeve të nomenklaturës shqyrtimin dhe marrjen e 519 *masave disiplinore dhe administrative,* lloji dhe zbatimi i të cilave, sipas njoftimeve zyrtare me shkrim nga organet përkatëse dhe rikontrollit të zbatimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, paraqitet si vijon:

| Nr. | Lloji i masës | Propozuar Gjithsej | Gjendja aktuale e zbatimit | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Të zbatuara | Pa përgjigje | % realizimit |
| 1 | "Vërejtje me shkrim" | 78 | 34 | 44 | 43.5 |
| 2 | "Vërejtje me paralajmërim" | 151 | 102 | 49 | 67.5 |
| 3 | "Pezullim ngritje në detyrë" | 4 | - | 4 | 0 |
| 4 | "Kalim në një nivel më të ulët" | 60 | 5 | 55 | 8.3 |
| 5 | "Largim nga shërbimi civil" | 17 | 7 | 10 | 41.1 |
| 6 | "Largim nga detyra" | 8 | 3 | 5 | 37.5 |
| 7 | "Largim nga puna" | 48 | 13 | 35 | 27 |
| 8 | Masa administrative (gjoba) | 23 | 10 | 13 | 43.4 |
| 9 | Në kompetencë të APP-së | 130 | 46 | 84 | 35.3 |
| | Shuma | 519 | 220 | 299 | 42.3 |

Në bazë të ligjit për KLSH-në, për masat e kërkuara dhe llojin e tyre është njoftuar dhe Departamenti i Administratës Publike, Tiranë.

Gjatë kësaj periudhe, nga ana e KLSH-së janë bërë *20 kallëzime penale*, e konkretisht për:

- Agjencinë e Kërkimit dhe Inovacionit, Tiranë
- Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë
- Ministria e Punëve, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Tiranë, 4 (katër) kallëzime penale
- Qendrën e Trajtimi të Studentëve, Sh.a., Shkodër
- Bashkia Durrës, 2 (dy) kallëzime penale
- Bashkinë Përmet
- Bashkinë Kavajë
- Bashkinë Kuçovë
- Bashkia Sarandë
- Komunën Bërzhit, Qarku Tiranë
- Komunën Levan, Fier
- Komunën Gjinar, Elbasan
- ALUIZNI, Vlorë
- Ish-Auditues në KLSH, 3 (tre) kallëzime penale

Nga 20 kallëzimet penale: 18 janë në hetim, ndërsa për dy të tjerat prokuroria ka vendosur për mosfillim të procedimit penal, të cilat janë të pasqyruara në mënyrë më të detajuar në formularin bashkëlidhur.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

- EVIDENCA E EMËRTIMIT TË SUBJEKTEVE TË AUDITUARA NGA KLSH, PËR TË CILËT JANË EVADUAR REZULTATET E AUDITIMIT
- EVIDENCA PËRMBLEDHËSE E ZBULIMEVE TË KONSTATUARA GJATË AUDITIMEVE TË USHTRUARA PËR TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET
- EVIDENCA E MASAVE DISIPLINORE DHE ADMINISTRATIVE TË REKOMANDUARA DHE ZBATIMI I TYRE
- EVIDENCA E KALLËZIMEVE PENALE TË NGRITURA NGA KLSH
- EVIDENCA E SHQYRTIMIT TË ANKESAVE DHE KËRKESAVE DREJTUAR KLSH

Formulari 1

EMËRTIMI I SUBJEKTEVE TË AUDITUAR NGA KLSH, PËR TË CILËT JANË EVADUAR REZULTATET E AUDITIMIT GJATË 6-MUJORIT TË PARË - 2013

## I. DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QENDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE, MENAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

1. Ministria e Integrimit, Tiranë
2. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Tiranë
3. Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës, Tiranë
4. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Tiranë
5. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë
6. Agjencia e Kërkimit Teknik dhe Inovacionit, Tiranë
7. Agjencia e Prokurimit Publik, Tiranë
8. Autoriteti Rrugor Shqiptar
9. Avokati i Prokurimeve, Tiranë
10. Aparati i Keshillit te Ministarve, Tiranë
11. Qendra Kombëtare e Kinomatografisë, Tiranë
12. Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë
13. Instituti i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë
14. Instituti i Statistikës, Tiranë
15. Inspektoriati Shtetëror i Punës, Tiranë
16. Inspektoriati i Lartë i Kontrollit të Deklarimit të Pasurive, Tiranë
17. Zbatimi i rekomandimeve të vitit 2012

## II. DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT TË PUSHTETIT VENDOR, KONTROLLIT TË TERRITORIT, ADMINISTRIMIT DHE PRIVATIZIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

1. Bashkia Manëz
2. Bashkia Sukth
3. Bashkia Fushë-Krujë

4. Bashkia Divjakë

5. Bashkia Kavajë

6. Bashkia Vau-Dejës

7. Bashkia Koplik

8. Bashkia Kuçovë

9. Bashkia Belsh

10. Bashkia Çorovodë

11. Bashkia Konispol

12. Bashkia Krumë

13. Bashkia Fier

14. Bashkia Durrës

15. Bashkia Libohovë

16. Bashkia Fushë-Arëz

17. Bashkia Bilisht

18. Bashkia Roskovec

19. Komuna Kolsh, Kukës

20. Komuna Xarë, Sarandë

21. Komuna Levan, Fier

22. Komuna Dishnicë, Përmet

23. Komuna Gjinar, Elbasan

24. Ndërmarja nr. 1, Bashkia Tiranë

25. Ndërmarja nr. 2, Bashkia Tiranë

26. Ndërmarja nr. 3, Bashkia Tiranë

27. Prefektura Korçë

28. Zbatimi i rekomandimeve të vitit 2012

## III. DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË INVESTIMEVE DHE PROJEKTEVE ME FINANCIME TË HUAJA, SHOQËRIVE PUBLIKE DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

1. Projekti “Furnizimi me ujë në qytetet Berat e Kuçovë”

2. Projekti “Rehabilitimi i hidrocentralit Bistrica 1 e 2”, KESH Sh.a.

